

10th **Safety Gala** **Albania**

TIRANA INTERNATIONAL SAFETY CONFERENCE

Mr. Aldi Kareco

Judge at the Court of First Instance of General Jurisdiction, Durrës

ERMMC
member of
MANAGEMENT FORCE Group
RISK MANAGEMENT & EHSS CONSULTANCY SERVICES

SAFETY SYNERGY
Competence, Growth & Sharing



Marrëdhënia juridike e punës dhe rregullimi në Kodin e Punës

Marrëdhënia juridike është një lidhje shoqërore midis dy ose më shumë subjekteve (persona fizik dhe/ose persona juridik), e cila rregullohet nga norma juridike dhe krijon të drejta dhe detyrime për palët.

Neni 12 i KP (Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë), me titull “Kontrata e punës”

- *Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.*

Në analizë të kësaj dispozite, kontrata e punës karakterizohet nga ekzistenca njëherazi e katër elementeve të veçantë:

- i. Punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e tij; Me “punë” ose “shërbim” kuptojmë çdo lloj aktiviteti manual apo intelektual. Punëmarrësi ofron punën, si të tillë, pavarësisht nga rezultati.*
- ii. Punëmarrësi ofron punën në një periudhë të caktuar apo të pacaktuar kohe. Në kontratën e punës, punëmarrësi i ofron punëdhënësit kohën e tij, pra i vë në dispozicion kohën dhe jo rezultatin e njëaktiviteti.*
- iii. Punëmarrësi ofron punën ose shërbimin e tij në kuadrin e organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit. Varësia e punëmarrësit nga punëdhënësi është një nga elementët thelbësor të kontratës së punës. Varësia manifestohet zakonisht në tre aspekte. Në aspektin kohor, punëmarrësi respekton orarin e përcaktuar nga punëdhënësi. Në aspektin hapësinor, punëmarrësi punon në vendin e punës së caktuar nga punëdhënësi. Në aspektin hierarkik, punëmarrësi punon sipas urdhrave dhe udhëzimeve të punëdhënësit.*
- iv. Punëmarrësi kryen shërbimin e tij kundrejt një shpërblimi. Paga është elementi i katërt thelbësor i kontratës së punës. Është e rëndësishme të kuptohet që në parim, paga i jepet punëmarrësit për vënien në dispozicion të kohës së tij*

Shih Vendimin nr. 00-2012-2243 (405), datë 25.9.2012 të Kolegjit Civil të GJL

KREU VI i KP, me titull “Detyrimet e punëmarrësit”

- I. Neni 22, me titull “Kryerja e punës personalisht;
- II. Neni 23, me titull “Detyrimi i bindjes”;
- III. Neni 24, me titull “Detyrimi i kujdesit në punë”;
- IV. Neni 25, me titull “Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit”;
- V. Neni 26, me titull “Detyrimi i besnikërisë”;
- VI. Neni 27, me titull “Përgjegjësisë e punëmarrësit”;

- 1. Punëmarrësi respekton urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit. 2. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që ndryshojnë kushtet e kontratës së punës. Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve. 3. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij.
- 1. Punëmarrësi kryhen me kujdes punën që i ngarkohet. 2. Punëmarrësi për kryerjen e punës duhet të përdorë sipas rregullave të caktuara mjetet e punës, aparaturat, mjetet e punëdhënësit dhe pajisjet e vëna në dispozicion të tij.

KREU VII i KP, me titull “Detyrimet e përgjithshme të punëmarrësit”

- I.** Neni 32, me titull “Mbrojtja e personalitetit”;
- II.** Neni 33, me titull “Mbrojtja e të dhënave”;
- III.** Neni 33/1, me titull “Informimi dhe konsultimi”;
- IV.** Neni 34, me titull “Kontrolli i sendeve vetjake”;
- V.** Neni 35, me titull “Vërtetimi i punës”;
- VI.** Neni 36, me titull “Regjistri”;
- VII.** Neni 37, me titull “Masat disiplinore”;

KREU VIII i KP, me titull “Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit”

Neni 39, me titull “Përgjegjësia e punëdhënësit”

- 1. Punëdhënësi, për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale, duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik.
- 2. Punëdhënësi duhet të paguajë diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore, kur aksidenti ose sëmundja profesionale është pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit.
- 3. Kur punëdhënësi nuk ka regjistruar punëmarrësin në sigurimet shoqërore, ai duhet të përballojë të gjitha shpenzimet që ka bërë punëmarrësi si rezultat i aksidentit ose sëmundjes profesionale, si dhe të gjitha dëmet si pasojë e mosregjistrimit.

Neni 40, me titull “Masa të përgjithshme”

- 1. Punëdhënësi detyrohet të kujdeset për higjienën e vendeve të punës. Punëdhënësi pasi konsultohet me punëmarrësit, duhet të marrë masat e nevojshme mbrojtëse kundër rreziqeve të veçanta që paraqesin substancat dhe agentët helmues, makinat, transporti i peshave të rënda, ndotja e ajrit, zhurmat dhe dridhjet, si dhe rreziqeve në disa degë të ekonomisë, si ndërtim, xhenio civile, miniera dhe industri kimike. Punëdhënësi duhet të vendosë sinjale të dallueshme qartë në çdo vend pune, që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve
- 2. Kur natyra e punës paraqet rreziqe të veçanta për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, sipas pikës 1, të këtij neni, punëdhënësi organizon, me shpenzimet e tij, në mënyrë periodike, si dhe sipas këshillimit të mjekut të ndërmarrjes, vizita mjekësore profesionale dhe ekzaminime mjekësore shtesë të punëmarrësit, para marrjes në punë dhe gjatë marrëdhënies së punës.
- 3. Masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit përcaktohen me VKM.

KREU VIII i KP, me titull “Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit”

Neni 43, me titull “Kualifikimi i punëmarrësve. Marrja e masave mbrojtëse.”

- 1. Punëdhënësi duhet të informojë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe duhet t'i kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës.
- 2. Kualifikimi dhe informimi i parashikuar në paragrafin e mësipërm bëhen gjatë marrjes në punë dhe përsëriten sipas nevojës, veçanërisht në rast të ndryshimit të kushteve të punës. 3. Punëdhënësi duhet t'u shpjegojë punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve domosdoshmërinë e zbatimit të masave të sigurimit teknik dhe higjienës.

Neni 44

- 1. Punëmarrësi duhet të zbatojë masat e parashtruara nga punëdhënësi dhe ta informojë atë në rast vështirësie për zbatimin e tyre.
- 2. Vetëm personat e kualifikuar mund të drejtojnë makineritë dhe pajisjet e transportit, mekanike ose elektrike.

“Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit” detajohet në vijim brenda Kreut, në nën kategori.

- **Gërma A, me titull “Vendi i punës”**

➤ **Neni 45, me titull “Rregullimi i vendit të punës”;**

➤ **Neni 46, me titull “Qëndrueshmëria dhe pastërtia”;**

➤ **Neni 47, me titull “Riparimet”**

- *1. Vendi i punës, në të gjitha pjesët përbërëse, duhet të përshtatet me natyrën e punëve që do të kryhen aty.*
- *2. Sipërfaqja dhe vëllimi i vendit të punës duhet të jenë të mjaftueshme për punëmarrësin, që ai të ketë mundësi të kryejë punën në siguri të plotë dhe pa penguar qarkullimin në mjedis.*
- *3. Instalimi i makinerive, pajisjeve dhe magazinimi nuk duhet të pengojnë qarkullimin dhe të zënë hapësirat ku punohet.*
- *4. Për aq sa është e mundur, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin e hapësirave në vendin e punës nga ana e personave me aftësi të kufizuara.*
- *5. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.*

“Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit” detajohet në vijim brenda Kreut, në nën kategori.

Gërma B, me titull “Mjedisi i punës”

Neni 48, me titull “Parime”, parashikon se:

- *Punëdhënësi merr të gjitha masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit të punës nga ndotja e ajrit, lëndët kimike, radioaktiviteti, zhurmat dhe dridhjet, si dhe çdo element të ngjashëm që është i dëmshëm për jetën dhe shëndetin e punëmarrësit.*
- *Këshilli i Ministrave ose organi i autorizuar prej tij përcakton masat që duhet të ndërmerren punëdhënësi dhe kufijtë e lejueshëm të elementeve, në zbatim të pikës 1 të këtij neni.”*

Gërma C, me titull “Makineri të rrezikshme”

Neni 51, me titull “Mbrojtja e përgjithshme”, parashikon se:

- *1. Asnjë punëmarrës nuk duhet të përdorë makineri pa marrë paraprakisht të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme.*
- *2. Pjesët e rrezikshme të makinerive duhet të pajisen me mjete mbrojtëse.*

“Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit” detajohet në vijim brenda Kreut, në nën kategori.

- Gërma D, me titull “Kushte pune dhe ngarkesa”;
- Gërma E, me titull “Levizja dhe rëniet”;
- Gërma F, me titull “Zjarret dhe shpërthimet”;
- Gërma G, me titull “Pijet Ngrënia”;
- Gërma H, me titull “Garderoba. Instalimet sanitare”

Psh neni 63 i KP, përfshihet te gërma F, parashikon se:

- *1. Punëdhënësi duhet të bëjë analizën e rrezikut të zjarrit ose shpërthimit dhe të marrë masat e nevojshme për parandalimin e tyre, duke mbajtur parasysh natyrën e lëndëve të përdorura dhe mjedisin dhe të proceseve të punës.*
- *2. Ambient shpërthyes është përzierja në ajër në kushte atmosferike e substancave të djegshme, në formën e gazrave, avujve ose pluhurave, ku, pas marrjes flakë, flakët përhapen në tërësinë e përzierjeve të padjegura.*
- *3. Këshilli i Ministrave përcakton kërkesat minimale të mbrojtjes së punëtorëve nga rreziku i ambienteve shpërthyes.*

PËRGJEGJËSIA CIVILE NGA AKSIDENTET NË PUNË

Neni 5/1 i Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me titull “Përkufizime”, parashikon se: *“Aksident në punë ose për shkak të punës” është çdo ngjarje e papritur, që shkakton dëmtimin e menjëhershëm trupor, që ndodh gjatë kryerjes së punës apo të një shërbimi lidhur me të, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje e përgjithshme, por që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje.*

E Drejta e Jetës

(Neni 2 i KEDNJ dhe Neni 21 i Kushtetutës)

- In the context of activities which may pose a risk to human life due to their inherently hazardous nature, such as activities carried out on construction sites, States are required to take reasonable measures to ensure the safety of individuals as necessary, including through regulations geared to the special features of the activity (Cevrioğlu v. Turkey, 2016, § 57 with further references).
- In particular, in the absence of necessary safety precautions, any construction site, especially one in a residential area, has the potential for life-endangering accidents that may impact on not only professional construction workers, who are more familiar with the possible risks, but also on the public at large, including vulnerable groups such as children, who may easily become subject to those risks (Zinatullin v. Russia, 2020, § 28).

Përgjegjësia civile nga aksidenetet në punë

Përgjegjësia në raport me punëmarrësin

Neni 39/2, me titull “Përgjegjësia e punëdhënësit”, i KP parashikon se:

2. Punëdhënësi duhet të paguajë diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore, kur aksidenti ose sëmundja profesionale është pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit.

Përgjegjësia në raport me të tretin

Neni 618, me titull “Përgjegjësia e punëdhënësit”, i Kodit Civil parashikon se:

Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij. Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Vendimi nr. 615 (2014), datë 24.7.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

- Fakti: Më datë 15.1.2018, ora 09:00, në Rrugën “Antipatrea”, Berat, shtetasi EP, punonjës i Shoqërisë T., me detyrë shofer, duke drejtuar automjetin e Shoqërisë, shkakton aksident, ku humb jetën shtetasi EE dhe dëmtohet shtetasi KK.
- Në bazë të Vendimit nr. 333, datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor shtetasi EP është dënuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i KP.
- Familjarët e viktimës EE dhe shtetasi KK i janë drejtuar me padi gjykatës duke kërkuar nga Shoqëria T... shpërblimin e dëmit nga aksidenti në punë, bazuar në nenin 618 të KC.
- Vlerësimi i gjykatës dhe vendimmarrja: Gjykata si vlerësoi urdhrin e punës së shtetasit EP, konstatoi se ai ditën e ngjarjes po udhëtonte nga Tirana për në Skrapar, ku ishte pozicioni i punës referuar urdhrit. Pra aksidenti nuk kishte ndodhur gjatë orarit të punës dhe në vendin e punës. Gjithashtu, bazuar në vendimin penal (cituar më lartë), shkak i aksidentit ishin shkeljet e Kodit Rrugor jo të Kodit të Punës. Gjykata në përfundim vendosi rrëzimin e padisë.

Kushtet për lindjen e përgjegjësisë për shpërblimini e dëmit nga aksidentet në punë

Neni 608, me titull “Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit”, i Kodit Civil parashikon se:

“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”

Përgjegjësia Aquilane

- *Nje nga parimet themeltare te bashkejeteses ne shoqerine njerezore eshte ndalimi per t'i shkaktuar dem tjetrit (alterum non laedere ose neminem laedere). Zbatimi i tij gjen rregullim te pergjithshem ne Kodin Civil dhe ne vecanti ne dispozitat mbi pergjegjesine civile jashtekontraktore te parashikuara nga nenet 608 e vijues te tij. Ne baze te kesaj pergjegjesie, e njohur si “pergjegjesia akuilane” (lex Aquilia de damno), cilido qe shkel te drejtat dhe interesat e ligjshme te nje tjetri detyrohet t'a demshperbleje ate. Nepermjet demshperblimit synohet pikerisht rivendosja e plote e te demtuarit (restitutio in integrum) ne gjendjen e meparshme (status quo ante), ne te cilen ai do te gjendej nese nuk ndodhte fakti i paligjshem (Shih Vendimin Unifikues Civil nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të GJL).*

4 ELEMENTËT

- Në kuptim të neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil, që të lindin detyrimet nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të konkurrojnë njëkohësisht disa kushte:
- 1) Ekzistenca e një paligjshmërie, nga ana e personit për të cilin pretendohet se ka shkaktuar dëmin. Situata e paligjshmërisë konsiston në veprime ose mosveprime që kanë sjellë shkeljen apo cenimin e të drejtave ose interesave të mbrojtura nga ligji. Paligjshmëria është një kategori objektive çka nënkupton se padijenja e personit nuk e përjashton atë nga përgjegjësia civile.
- 2) Ekzistenca e dëmit, pra pasoja që i ka ardhur personit në pasurinë e tij për shkak të veprimit ose mosveprimit të paligjshëm.
- 3) Ekzistenca e lidhjes shkakësore, dëmi duhet të jetë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e veprimit ose mosveprimit të paligjshëm.
- 4) Fajësia (në formën e dashjes ose pakujdesisë) e personit nga i cili kërkohet shpërblimi i dëmit. Personi për të cilin pretendohet se ka shkaktuar dëmin ka edhe barrën e provës për të provuar nëse ka apo jo faj për ardhjen e tij (Shih Vendimin nr. 00-2025-2948 (346), datë 10.7.2025 të Kolegjit Civil të GJL).

Lidhur me dëmin. Dëmi është ndarë në dy kategori: (i) dëmi pasuror dhe (ii) dëmi jopasuror.

- Dëmi pasuror = *Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore (neni 640 i KC).*
- *Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar (neni 643 i KC).*
- *Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga: a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paafte për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit; b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit (Neni 645 i KC).*
- Dëmi jopasuror ndahet në tre nënkategori, të cilat janë: a) dëmi biologjik; b) dëmi moral; dhe c) dëmi ekzistencial.
- *Dëmtimi i shëndetit (demi biologjik) perben, në thelb, cenimin e se mires se shendetit, te integritetit fizik dhe/ose psikik te njeriut. Ky dem jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 te Kodit Civil, (...)*
- *Demi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) eshte shfaqje e brendshme, e perkohshme, e turbullimit te padrejte (non iure perturbatio) te gjendjes shpirtore te njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtoror qe rrjedh si pasoje e faktit te paligjshem. Cilido qe peson cenime ne sferen e shendetit dhe te personalitetit te tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj te nje te treti ka te drejten te kerkoje edhe demshperblimin e demit moral te pesuar.*
- *Demi ekzistencial. Per shkak te nje gjendjeje te tille psiko-fizike, i demtuari nuk mund te kryeje me veprimtari te caktuara qe karakterizonin pozitivisht qenien e tij apo mund t’a karakterizonin pozitivisht ne te ardhmen, duke e detyruar te shtyhet drejt zgjidhjeve te ndryshme ne jete nga ato te deshiruara e te pritshme apo ne heqjen dore nga keto te fundit per shkak te vertetimit te faktit te paligjshem.*

LIDHJA SHKAKËSORE (CASUALITY)

- Lidhja shkakësore është raporti që krijohet ndërmjet shkakut dhe pasojës, ose më qartë diçka ndodhë sepse diçka e ka shkaktuar.
- *Nëpërmjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet tre elementëve objektivë e subjektivë të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit): sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurinë e tij (objektiv) (Shih Vendimin nr. 00-2022-473 (37), datë 2.2.2022 të Kolegjit Civil të GJL).*

Teoria e shkikut të drejtëpërdrejtë dhe të domosdoshëm (determinant)

- (...) Doktrina dhe praktika gjyqësore shqiptare ka përqafuar pikëpamjen sipas së cilës, lidhja që ekziston midis veprimit dhe mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojës që ka ardhur ose që, mund të vijë prej tij, quhet lidhje shkakësore, kauzale. E drejta penale shqiptare dhe praktika e saj gjyqësore, konsiderojnë shkak kryesor të veprës penale atë veprim ose mosveprim të drejtëpërdrejtë, i cili sjell në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës, apo mundësinë e ardhjes së saj, të cilin e quan shkaku i domosdoshëm i drejtëpërdrejtë, determinant. Duke përcaktuar atë që e quan shkaku kryesor, e drejta penale bën njëkohësisht edhe dallimin midis tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët edhe pse mund të kenë një farë lidhjeje me pasojën, nuk luajnë rol përsa i takon marrjes ose jo të disa personave, në përgjegjësi penale (Shih Vendimin nr. 00-2025-357 (51), datë 27.2.2025 të Kolegjit Penal të GJL).

Vendimi nr. 53-2025-147 (49), datë 24.1.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

- Fakti: Rezulton se më datë 2.6.2020, YN ka qenë duke punuar në objektin që Shoqëria S... po ndërtonte përgjatë rrugës së Kunes. Duke punuar në katin e dytë të objektit, në cepin e ashensorit, në fasadën e jashtme të ndërtesës, por hynte shpesh brenda saj për të marrë material. Në një moment, tek përsëriste manovrën, ai ka rrëshkitur mbi disa guralecë dhe ka rrënë në tokë nga kati i dytë. Pas kësaj ngjarje është përcjellë në spital për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore.
- YN kërkonte shpërblimin e dëmit. Shkelja e rregullave të sigurisë në punë u konstatua edhe Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili më Vendimin përfundimtar nr. ISHPSHSH-LE-2020-000217-5, datë 24.6.2020.
- Vlerësimi i gjykatës: Nga akti i ekspertimit teknik është konkluduar se nga ana e palës së paditur janë kryer këto shkelje: (i) në përputhje me nenin 39/1 të KP nuk janë përcaktuar qartë rregullat e sigurimit në punë me qëllim parandalimin e aksidenteve në punë. As nga dosja penale nuk rezulton që pala e paditur të ketë dorëzuar gjatë hetimit prova lidhur me këtë konstatim, por as gjatë këtij gjykimi pala e paditur nuk dorëzoi as një provë për të përmbysur këtë konstatim të ekspertit. Në përputhje me nenin 12 të KPC, barra e provës i përkiste të paditurit;

Vazhdon...

- (ii) në shkelje të nenit 7, pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe Shtojca II, pika 9 të VKM nr. 562 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, nuk provohet të jetë bërë trajnimi dhe instruktimi i punëmarrësve mbi rregullat e mbrojtjes në punë. Gjykata konstaton se në fashikullin penal është një formular i nënshkruar në tre data, me diferencë 1 muor nga njëri-tjetri, por Gjykata vlerëson se formulari ka natyrë krejt formale dhe nuk përshkruan për çfarë janë trajnuar punëmarrësit. Trajnimi duhet të jetë i qenësishëm dhe jo formal, përkundër formaliteti është i barasvlefshëm me mungesën, kjo referuar natyrës vërtetë të rrezikshme të punës së punëmarrësve në ndërtim; (iii) nuk është ngritur Këshilli i Sigurisë në Punë, cituar edhe nga ISHP; (iv) në shkelje të VKM nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për sigurinë në kantier” Pjesa B “Seksioni II – Vendet e punës në kantiere në mjedis të jashtëm”, pika 5/1, duke mos u bërë ndërtimi i skelave të përkohshme. *Në punimet që kryhen në një lartësi më të madhe se dy metra, duhet të merren masa për ndërtimin e skelave të përkohshme për realizimin e këtyre punimeve. Ato duhet të ndërtohen me strukturat të përshtatshme ose të ngjashme dhe duke parashikuar masa për të eliminuar rreziqet e rënies së personave dhe materialeve nga lartësia.*
- Gjykata vendosi pranimin e padisë në shumën 6,763,896 (gjashtë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

Konkurojnë veprimet e kundërligjshme

- Nga Vendimi nr. 00-2023-5025, date 6.12.2023 i KCGJL rezulton se shtetasi B.B, me detyrë elektrikist në Ndërmarrjen e Naftës Patos, me urdhër të shefit të sektorit, ka shkuar për të rregulluar një defekt elektrik në kabinën elektrike, të konstatuar nga ana e grupit të natës. Ndërkohë që ishte duke rregulluar këtë defekt, ai ka rënë në tension dhe si pasojë ka gjetur vdekjen. Në përfundim të hetimeve, organi procedues ka arritur në përfundimin se ka pasur shkelje të rregullave të sigurimit teknik dhe shfrytëzimit teknik në punë, por përgjegjësia direkte për shkeljen e tyre ka qenë e vetë viktimës B.B dhe për pasojë, me vendimin e datës 02.11.2011, ka vendosur pushimin e procedimit penal. Gjykatat e faktit kanë pranuar padinë për shpërblimin e dëmit, duke arsyetuar se vendimi i Prokurorisë për pushimin e procedimit penal, për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë” për shkak se vdekja ka ardhur si pasojë e veprimeve të vetë viktimës, nuk do të thotë se vendimi i gjykatës është i pabazuar.

Faji ka të bëjë me qëndrimin psikik që mban subjekti ndaj veprimit të kundërligjshëm

- **Faji në të drejtën civile presumohet!**

Konkurojnë veprimet e kundërligjshme

- **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret, në mosmarrëveshjen objekt gjykimi kemi të bëjmë me përgjegjësi të përzier, pasi nga ana e gjykatave të faktit duhej hetuar në mënyrë shteruese, nëse janë respektuar kushtet e rregullat që i përgjigjen profilit të punës që ushtronte punëmarrësi dhe nga ana tjetër punëdhënësi i ka marrë të gjitha masat logjistike për t'i krijuar mjedisin e përshtatshëm dhe konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për ushtrimin e detyrës së tij nga punëmarrësi, dhe në eventualitetin e mosplotësimit të këtyre kushteve nga punëdhënësit ka ardhur edhe pasoja konkrete, e humbjes së jetës nga punëmarrësit B.B. Pra, nuk është arsyetuar mbi përgjegjësinë konkrete të punëdhënësit.**

Efektet e vendimit penal në gjykimin civil për përcaktimin e përgjegjësisë civile

- Neni 70/1 i KPP parashikon se: “1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari.”.
- Nga një interpretim i kundërt (a contrario) i dispozitës, vendimi i pushimit të çështjes penale apo vendimi gjyqësor i pafajësisë, sipas neneve 387 dhe 388 të KPP, nuk ka efekt detyrues në gjykimin civil apo administrativ. (...) Kjo do të thotë se, vërtetimet e faktit apo konkluzionet e arritura nga gjykata penale, në vendimin gjyqësor të pushimit të çështjes penale ose të pafajësisë, të cilat janë të disfavorshme për palën e dëmtuar nga fakti i paligjshëm, nuk janë detyruese për gjykatën që shqyrton pretendimet civile/administrative, për sa kohë, pala e dëmtuar nga fakti i paligjshëm nuk ka qenë pjesëmarrës në gjykimin penal dhe nuk ka patur mundësi t’i debatojë në një gjykim kontradiktor (Shih Vendimin nr. 00-2023-342 (52), datë 13.2.2023 të Kolegjit Administrativ të GJL).

Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme

- Neni 622 i KC parashikon se:
“Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.”.
- *Në rastin e një veprimtarie të tillë që është e rrezikshme, për shkak të natyrës së saj ose natyrës së sendeve të përdorura nuk mund të flitet për përgjegjësi subjektive, pasi personi që e ushtron atë mban përgjegjësi, pavarësisht nëse ka kryer ose jo veprime të kundërligjshme, apo nëse ka vepruar ose jo me faj. Prezumimi, si çlirim nga barra e provës, konsiston në atë që disa fakte mund të deduktohen nga ekzistenca e fakteve të tjera me të cilat të parat kanë një lidhje shkakësore të domosdoshme dhe të drejtëpërdrejtë. Kështu, prezumimi bazohet në mekanizmin e lidhjes shkak-pasojë, ku një fakt zakonisht shoqërohet nga një tjetër ose është shkak apo pasojë e një tjetri (...)*



FAEMINDERIT !